



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim për shtyp**

**Mbi autorizimin e  
përqendrimin e realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 76 % të  
aksioneve të OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe  
Energjetikës tek shoqëria Cez a.s.**

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 15.05.2009 ka miratuar autorizimin e përqendrimin të realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 76 % të aksioneve të OSSH SH.A nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek shoqëria Cez a.s.

Transaksioni i blerjes së 76 % të aksioneve të shoqërisë OSSH SH.A nga Shoqëria Cez a.s. është realizuar nëpërmjet “Marrëveshjes për blerje aksionesh” e datës 11 Mars 2009, nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, (METE) dhe shoqëria Cez a.s. Marrëveshja e datës 11 Mars 2009 e përqendrimit të synuar është miratuar nga Kuvendi me datë 23 Prill 2009.

Transaksioni i njoftuar paraqitet si përfundim kontrolli i drejtëpërdrejtë ku OSSH SH.A do kontrollohet nga aksioneri mazhoritar Cez a.s si zotërues i 76% të kapitalit aksioner me të drejtë vote. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si përfaqësues i shtetit shqiptar do të zotërojë 24 % të aksioneve.

Tregu i shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike është një treg i rregulluar nën mbikqyrjen e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, i cili ka kompetencë të miratojë tarifën dhe metodologjinë e llogaritjes së çmimit për konsumatorët finalë.

**Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të vazhdueshme tregun e energjisë elektrike.**